



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 600/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lagjia Kalabria, rr. “Rexhep Krasniqi”, kundër debitorit “A-R...”, Sh.p.k., me seli në Prishtinë, rr. “...” ..., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 516/2020 të datës 07.09.2020, të Përmbartuesit Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 05.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “A-R...”, Sh.p.k., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.516/2020 të datës 07.09.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj.

II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.516/2020 të datës 07.09.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj.

A r s y e t i m

Kreditori, Dogana e Kosovës ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit “A-R...”, Sh.p.k, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartues – Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Drejtoria Rajonale – ZBD Pejë, me numër të protokollit 2392/1-02.5.1, i datës 26.02.2019, i formës së prerë me datë 19.07.2020 dhe i ekzekutueshëm me datë 19.08.2020, me të cilin debitori është obliguar që kreditorit në emër të detyrimeve doganore për DUD- in R 8517/21/06/2016, t’ia paguaj shumën prej 9,133.42 € (nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e tri euro e dyzet e dy cent).

Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës të datës 04.09.2020, me datë 07.09.2020, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.516/2020, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit

përmbarues, Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Drejtoria Rajonale – ZBD Pejë me numër të protokollit 2392/1-02.5.1, i datës 26.02.2019.

Kreditori në propozimin për përmbarim të datës 04.09.2020, ka kërkuar që të detyrohet debitori “A-R....”, Sh.p.k, t’ia paguaj kreditorit Dogana e Kosovës, detyrimin doganor për DUD- in R 8517/21/06/2016, në shumën prej 9,133.42 € (nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e tri euro e dyzet e dy cent), nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, nëse debitori nuk e përmbush detyrimin të bëhet bllokimi i llogarive bankare të debitorit dhe të hollat të transferohen në llogarinë e kreditorit, të bëhet sekuestrimi i letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbarimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbarimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme, kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe shpenzimet tjera të krijuara, sipas Udhëzimit Administrativ MD.NR.06/2014.

Debitori ka parashtruar prapësim me shkrim, në të cilin ka theksuar se vendimi i Doganës së Kosovës nuk është titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë sipas nenit 71, par.1, nën par. 1.1, ndërsa taksat shtesë doganore janë caktuar me Vendimi R-8517, i datës 24.06.2016, vendim ky i cili është vërtetuar me Aktvendimin 06.2/555; 596 të datës 08.08.2016, andaj pasi që taksat doganore janë caktuar sipas këtyre vendimeve, procedura e përmbarimit është dashur të inicohet sipas këtyre vendimeve. Tutje ka shtuar se urdhri për përmbarim nuk është dokument i nxjerrë në procedurë administrative dhe nuk është dokument përmbarimor sipas nenit 24 par. 3 të LPP-së. Aktvendimi i datës 26.02.2019 ka vendosur mbi çështje të gjykuar me vendim dhe i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbarim sipas nenit 27 të LPP-së. Ka theksuar se Aktvendimi në bazë të të cilit është lejuar përmbarimi, nuk përmban objektin, mjetet dhe kohën e përmbushjes së detyrimit. Ndër të tjera ka shtuar se detyrimet doganore shtesë të importuara nga Dogana e Kosovës përveç që janë importuar në mënyrë arbitrare dhe plotësisht të pabazuara, të njëjtat janë objekt shqyrtimi sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm pranë Gjykatës Supreme, prandaj deri në një vendim të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin do të konstatohet bazueshmëria e vendimeve të Doganës së Kosovës, realizimi i kredisë është i parandaluar përkohësisht siç përcaktohet në nenin 71 par.1, nën par. 1.9 të LPP-së. Ka shtuar se

debitori është në gjendje të vështirë financiare dhe në këtë kohë e ka të pamundur të bëjë pagesën e obligimeve shtesë doganore. I ka propozuar gjyktës që prapësimi i debitorit të aprovohet ndërsa urdhri përmbartimor dhe të gjitha veprimet përmbartimore të anulohen.

Kreditori me përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit në prapësim si të pabazuara për faktin se urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të aktvendimit të Doganës së Kosovës si dokument ekzekutiv dhe se kreditori propozimin për përmbartim e ka parashtuar në bazë të aktvendimit të nxjerrë në procedurën administrative dhe i njëjti është i ekzekutueshëm sipas nenit 22 të LPP-së. Ka shtuar se pretendimet e debitorit se ka parashtuar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative është pretendimi i pabazuar ngase sipas nenit 22 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, padia nuk e ndalon ekzekutimin e tij e aq më pak mjetet e jashtëzakonshme. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata konstaton se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin mbështetur në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka vlerësuar dokumentin përmbartimor Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Drejtoria Rajonale – ZBD Pejë, me numër të protokollit 2392/1-02.5.1, i datës 26.02.2019, në bazë të të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafit paragrafit 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu Aktvendimi i Doganës së

Kosovës, Drejtoria Rajonale – ZBD Pejë, me numër të protokollit 2392/1-02.5.1, i datës 26.02.2019, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Drejtoria Rajonale – ZBD Pejë me numër të protokollit 2392/1-02.5.1, i datës 26.02.2019, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmëris për përbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Drejtoria Rajonale – ZBD Pejë me numër të protokollit 2392/1-02.5.1, i datës 26.02.2019, është bërë i formës së prerë me datë 19.07.2020 dhe i ekzekutueshëm me datë 19.08.2020.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm pranë Gjykatës Supreme mirëpo gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore ngase në Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, padia dhe mjetet e jashtëzakonshme nuk paraqesin bazë për ndalimin e ekzekutimit të aktit administrativ, siç përcaktohet në nenin 22 par.1 të Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*.

Me nenin 24 par. 3 të LPP-së është përcaktuar se: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.”*, prandaj në rastin konkret Aktvendimi i Doganës së Kosovës, Drejtoria Rajonale – ZBD Pejë, me numër të protokollit 2392/1-02.5.1, i datës 26.02.2019, është bërë i plotëfuqishëm dhe i ekzekutueshëm dhe fakti se debitori ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të

jashtëzakonshëm nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbartimore.

Më tej gjykata vlerëson se pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbartues nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.600/22, datë 05.09.2022

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.